

Raport sondazhi

Atmosfera e fundvitit në Tiranë



Janar 2025

Përmbajtja

Raport sondazhi	1
Përmbajtja	2
Rreth sondazhit	3
Demografia	4
Dekori i qytetit	5
Puna e Bashkisë gjatë periudhës së festave	6
Aktivitetet dhe promovimi i qytetit	7
Tirana si destinacion për festat e fundvitit	9
Sugjerime të hapura	11
Aneks I – Kampionimi	12
Aneks II – Pyetësi i sondazhit	13

Rreth sondazhit

Festat e fundvitit janë periudha më e bukur e vitit, atmosfera festive sjell tek të gjithë një ndjenjë shprese dhe kënaqësie. Kjo atmosferë e ngrohtë sjell më pranë miqtë dhe familjarët për të pritur natën e madhe të ndërrimit të viteve.

Bashkia e Tiranës me angazhimin e Ndërmarrjes së Dekorit dhe Eventeve, ka zbukuruar dhe ndriçuar qytetin, për ta bërë sa më tërheqës dhe festiv për vendasit dhe të huajt. Tirana çdo dhjetor bëhet magjike me shtëpizat e Krishtlindjeve në sheshin Skënderbej, krahas ndezjes së dritave në pemën e madhe të vendosur në qendër të sheshit, Bashkia ka menduar edhe për vende të tjera të posaçme për të festuar si Pazari i ri, Parku i Madh i Liqenit, Sheshi Italia, Kalaja e Tiranës etj.

Bashkia e Tiranës ka menduar edhe për vogëlushët, të cilët janë kryefjala e festave, lojërat e instaluar në sheshin Skënderbej, koncerte me këngë, kërcime dhe surpriza. Mbrëmjet festive në sheshin Skënderbej kanë krijuar super atmosferë në qytet që kulmon në natën e ndërrimit të viteve me spektaklin e fishekzjarreve dhe koncertin festiv që zgjat deri në orët e para të mëngjesit.

Qëllimi i sondazhit është të evidentojë opinionet e qytetarëve për atmosferën, dekorin e qytetit dhe aktivitetet që zhvillohen me rastin e festave të fundvitit në Tiranë.

Objektivat e sondazhit:

- a) Si e konsiderojnë qytetarët dekorin e festave të fundvitit të vendosur nga Bashkia;
- b) Vlerësimi i qytetarëve për punën e Bashkisë në organizimin, pastrimin e qytetit, infrastrukturën festive etj;
- c) A preferojnë qytetarët të marrin pjesë në aktivitetet që organizon Bashkia;
- d) A mendojnë se ndikojnë festat e fundvitit për të promovuar qytetin, kulturën, prodhimet vendase, produktet artizanale etj;
- e) A do t'a rekomandonin Tiranën si një destinacion për të kaluar festat e fundvitit;
- f) Sugjerime të hapura për të përmirësuar më tej atmosferën e festave të fundvitit.


Sondazhi u zhvillua gjatë periudhës **dhjetor 2024** dhe u anketuan rreth **221** qytetarë. Anketimi u krye nëpërmjet **intervistave ballë për ballë** me qytetarë rastësorë në disa pika të frekuentuara të Tiranës, si edhe **online në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë** [Bashkia Tiranë - Sondazhe \(tirana.al\)](http://Bashkia.Tirane-Sondazhe(tirana.al))¹, sipas një pyetëso² të strukturuar me pyetje të mbyllura dhe të hapura.

¹ Ankes I – Kampionimi



² Aneks II – Pyetëso² i sondazhit

Demografia

Nga 221 të anketuar për këtë sondazh: 123 të anketuar janë banorë të Tiranës; 22 banojnë në Greqi, 14 në Itali, 11 në Elbasan, 9 në Fier, 8 përkatësisht në Vlorë dhe Berat etj. (Grafiku Nr.1).




Rreth 51% e të anketuarve janë *gra dhe vajza*, ndërsa 49% meshkuj (Grafiku Nr.2). Grup-mosha me pjesëmarrje më të lartë në sondazh është 36 – 50 vjeç (36%), 51 – 65 vjeç (28%), 18 – 35 vjeç (14%), nën 18 vjeç (12%) dhe mbi 65 vjeç (10%) (Grafiku Nr.3).




Dekori i qytetit

Dekorin festiv të vendosur nga Bashkia e Tiranës për festat e fundvitit, 48% e të anketuarve e konsiderojnë të bukur, 33% e konsiderojnë shumë të bukur, 14% disi të bukur, ndërsa 4% nuk kanë dhënë një përgjigje (Grafiku Nr.4).



Gjatë festave të fundvitit Bashkia e Tiranës vendos shtëpiza në qendër të qytetit, lojëra për fëmijë dhe të rritur, stenda me suvenire, libra etj., për të krijuar një atmosferë sa më festive dhe argëtuese. 57% e të anketuarve janë shprehur se këto *elementë të shtuar* krijojnë atmosferë festive në qytet (Po), 33% janë pjesërisht dakord etj. (Grafiku Nr.5).



Puna e Bashkisë gjatë periudhës së festave

Gjatë festave të fundvitit *Bashkia e Tiranës* angazhohet për të siguruar një mjedis më të këndshëm, të pastër, të mirëmbajtur dhe të sigurt. Në një vlerësim të shkallëzuar nga 1 në 5, ku 1 = aspak mirë dhe 5 = shumë mirë, vlerësimi i përgjithshëm për punën e Bashkisë gjatë festave të fundvitit është rreth 3.6 pikë.


Ndërkohë 52% e të anketuarve kanë vlerësuar me 4 pikë;

27% me 3 pikë;

11% me 5 pikë;

8% me 2 pikë;


1% me 1 pikë (*Grafiku Nr.6*).




Aktivitetet dhe promovimi i qytetit

Aktivitete të ndryshme kulturore, festive dhe promovuese zhvillohen gjatë periudhës së fundvitit. Koncertet në sheshin Skënderbej, shfaqjet e ndryshme dhe panairët zbukurojnë qytetin dhe shtojnë atmosferën e festave.

76% e të anketuarve janë shprehur se preferojnë të marrin pjesë në aktivitete apo të frekuentojnë vendet e dedikuara për pushim dhe argëtim, 14% nuk kanë dhënë një përgjigje, ndërsa 10% nuk preferojnë të marrin pjesë (Grafiku Nr.7).




64% e të anketuarve mendojnë se organizimi i eventeve gjatë festave të fundvitit, janë një rast i mirë për të njohur dhe promovuar kulturën, prodhimet vendase, gastronominë, produktet artizanale “Made in Albania”, 23% janë përgjigjur pjesërisht etj. (Grafiku Nr.8).




Tirana si destinacion për festat e fundvitit

64% e të anketuarve janë të mendimit se Tirana gjatë fundvitit *shndërrohet në një qytet tërheqës* si për vendasit dhe të huajt, ku ofrohet një atmosferë e ngrohtë dhe festive, 22% janë përgjigjur pjesërisht etj. (Grafiku Nr.9).



70% e të anketuarve kanë pohuar se do t'a rekomandonin *Tiranën si një destinacion për t'u vizituar gjatë festave të fundvitit*, 20% nuk kanë dhënë një përgjigje, ndërsa 10% janë përgjigjur se nuk do t'a rekomandonin (*Grafiku Nr.10*).



Sugjerime të hapura

Të anketuarit kanë dhënë sugjerime se si mund të përmirësohet më tej atmosfera gjatë festave të fundvitit në Tiranë:

- Manaxhim më të mirë të trafikut;
- Më shumë pastërti në vendet e frekuentuara;
- Të shtohen tualetet publike.

Aneks I - Kampionimi

Nr.	Pikat e anketimit	Pyetësorë të plotësuar
1	Sheshi Skënderbej	50
2	Pazari i Ri	30
3	Kalaja e Tiranës - Pedonale	30
4	Sheshi Italia - Arena	30
5	Zona e ish-Bllokut	30
6	Anketim online	51
Total pyetësorë		221

Aneks II – Pyetësi i sondazhit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E QEVERISJES ELEKTRONIKE DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
SEKTORI I KONSULTIMIT PUBLIK DHE OPINIONEVE QYTETARE

Nr. i pyetësit _____

Tiranë, më ____/____/2024

PYETËSOR - ATMOSFERA E FUNDVITIT NË TIRANË

<i>Qyteti/Shteti</i>	<i>Gjinia</i>		<i>Grup-mosha (vjeç)</i>				
	F	M	Nën 18	18-35	36-50	51-65	Mbi 65

- Si e konsideroni dekorin e përgjithshëm të vendosur nga Bashkia e Tiranës për festat e fundvitit?
 Shumë të bukur
 Të bukur
 Disi të bukur
 Nuk e di
- A mendoni se elementët e shtuar krijojnë atmosferë festive në qytet (*shtëpizat në qendër të Tiranës; lojërat për fëmijë dhe të rritur; stenda me suvenire, libra etj.*)?
 Po
 Jo
 Pjesërisht
 Nuk e di
- Si e vlerësoni në përgjithësi punën e Bashkisë Tiranë gjatë fundvitit kundrejt organizimit, sigurisë, pastrimit të qytetit, mirëmbajtjes së ndriçimit dhe infrastrukturës festive?

Aspak mirë – 1 2 3 4 5 – Shumë mirë

4. Preferoni të merrni pjesë në aktivitetet që organizohen nga Bashkia gjatë festave apo të frekuentoni vendet e dedikuara për pushim dhe argëtim?
- Po
- Jo
- Pa përgjigje
5. Mendoni se organizimi i eventeve gjatë festave të fundvitit, janë një rast i mirë për të njohur dhe promovuar kulturën, prodhimet vendase, gastronominë, produktet artizanale etj., “Made in Albania”?
- Po
- Jo
- Pjesërisht
- Nuk e di
6. Në opinionin tuaj, a shndërrohet Tirana gjatë fundvitit në një qytet tërheqës si për vendasit dhe të huajt, ku ofrohet një atmosferë e ngrohtë dhe festive?
- Po
- Jo
- Pjesërisht
- Nuk e di
7. A do ta rekomandonit Tiranën si një destinacion për t’u vizituar gjatë festave të fundvitit?
- Po
- Jo
- Nuk e di
8. Çfarë sugjeroni për të përmirësuar më tej atmosferën gjatë festave të fundvitit:

Shënim: Ky pyetësor organizohet nga Bashkia e Tiranës dhe ka për qëllim të evidentojë opinionet rreth atmosferës, dekorit të qytetit dhe aktiviteteve që zhvillohen me rastin e festave të fundvitit në Tiranë.

Ju sigurojmë që të dhënat tuaja janë për qëllim studimi dhe në përputhje me Ligjin nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”; Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”; Ligjin nr. 120/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar”.

Ju falënderojmë për kohën që i kushtuat plotësimit të këtij pyetësori dhe për mendimet që ndatë me ne, me vlerë për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve të Tiranës.